

VENDIM
Nr. 3, datë 1.4.2022

**PËR MIRATIMIN E MARZHEVE QË DO TË APLIKOHEN PËR DISA
PRODUKTE USHQIMORE BAZË, SI PASOJË E SITUATËS SË VEÇANTË TË
KRIJUAR NGA RRIJTJA E ÇMIMEVE NDËRKOMBËTARE**

Bordi i Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, në zbatim të aktit normativ nr. 7, datë 18.3.2022, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”,

VENDOSI:

1. Miratimin e marzheve që do të aplikohen për disa produkte ushqimore bazë, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar nga rritja e çmimeve ndërkombëtare.

2. Për artikullin oriz kokërrgjatë (1 kg) miratohen marzhet si më poshtë:

a) marzhi i tregtimit të shitjes me shumicë të orizit kokërrgjatë 12.4% mbi koston e importit dhe detyrimet e paguara në doganë, ose në vlerën 11 lekë/kg. Ky marzh mbulon edhe shpenzimet e ambalazhimit brenda vendit;

b) marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë të orizit kokërrgjatë 4% mbi çmimin e shitjes me shumicë, ose në vlerën 4 lekë/kg.

3. Për artikullin sheqer (1 kg) miratohen marzhet si më poshtë:

a) marzhi i tregtimit të shitjes me shumicë të sheqerit nga importuesi dhe ambalazhuesi 10.9% (3.7% + 7.2%) mbi koston e importit dhe detyrimet e paguara në doganë, ose në vlerën 12 lekë/kg;

b) marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë të sheqerit 3.4% mbi çmimin e shitjes me shumicë, ose në vlerën 4 lekë/kg.

4. Për artikullin vaj luledielli miratohen marzhet si më poshtë:

a) marzhi i tregtimit të shitjes me shumicë nga importuesit të vajit të ambalazhuar të lulediellit 12.5% mbi koston e importit dhe detyrimet e paguara në doganë, ose në vlerën 35 lekë/litër. Ky marzh mbulon edhe shpenzimet e inbotilimit dhe ambalazhimit;

b) marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë të vajit të ambalazhuar të lulediellit 1.9% mbi çmimin e shitjes me shumicë, ose në vlerën 6 lekë/litër.

5. Për artikullin miell masiv miratohen marzhet si më poshtë:

a) marzhi i tregtimit të shitjes me shumicë të miellit nga prodhuesi dhe ambalazhuesi 33% e koston së grurit të importuar, ose 21.5 lekë/kg. Ky marzh mbulon edhe kostot e përpunimit të grurit, prodhimin e miellit dhe ambalazhimit të tij;

b) marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë të miellit 4.6 % mbi çmimin e shitjes me shumicë, ose në vlerën 4 lekë/kg.

6. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha subjektet që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet e përcaktuara në këtë vendim.

7. Në pasqyrën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, jepen të dhënat në lidhje me përlogaritjet e çmimit të tregtimit sipas marzheve të përcaktuara në pikat 2, 3, 4 dhe 5, të këtij vendimi.

8. Ky vendim hyn në fuqi në datën 5.4.2022 dhe i shtrin efektet deri në mbledhjen e ardhshme të Bordit. Ky vendim do të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat dhe ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Ceno Klosi, Genti Gazheli, Nikolla Lera, Vjollca Ferro, Gentian Celo, Ermal Babameto, Frida Krifca, Irfan Tarelli, Jeta Deda, Fuad Haxhiymeri, Elona Hametaj Mema, Majlinda Bajraktari

PASQYRA NR. 1

Përshkrimi	Kosto në import dhe pagesa në doganë	Marzhi në import/shumicë		Marzhi me shumicë (importuesi i ndryshëm nga shitësi me shumicë)		Marzhi me pakicë		Çmimi i shitjes me pakicë	Sqarime
		%	vlerë	%	vlerë	%	vlerë		
Oriz Kokërrgjatë	89 lekë/kg	12.40%	11 lekë/kg			4%	4 lekë/kg	104 lekë/kg	Për shkak të varieteteve të ndryshme të orizit të importuar në thasë, baza e përdorur për llogaritjen e çmimit me shumicë të produktit është kosto më e ulët e zhdoganimit të produktit oriz ndërmjet datave 24–31 mars 2022 në nivel subjekti. Marzhi i shumicës mbulon kostot e ambalazhimit si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operacionale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar. Në rastet kur ndërmjet shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë operon një hallkë ndërmjetëse, marzhi i llogaritur 4% (4 lekë/kg) ndahet ndërmjet tyre.
Sheqer	107 lekë/kg	3.70%	4 lekë/kg	7.20%	8 lekë/kg	3.40%	4 lekë/kg	123 lekë/kg	Baza e përdorur për llogaritjen e çmimit me shumicë është kostoja mesatare e ponderuar e zhdoganimeve gjatë datave 24–31 mars 2022, ku për bazë janë marrë 99.4% e zhdoganimeve të sheqerit të papaketuar (3 subjektet me peshën më të lartë të zhdoganimit). Marzhi i shumicës mbulon kostot e ambalazhimit si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operacionale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar. Në rastet kur ndërmjet shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë operon një hallkë ndërmjetëse, marzhi i llogaritur 4% (4 lekë/kg) ndahet ndërmjet tyre.
Vaj luledielli	280 lekë/litër	12.50%	35 lekë/litër			1.90%	6 lekë/litër	321 lekë/litër	Baza e përdorur për llogaritjen e çmimit me shumicë është kostoja mesatare e ponderuar e

									zhdoganimeve gjatë datave 24–31 mars 2022, ku për bazë janë marrë 95.6% e zhdoganimeve të vajit të lulediellit (3 subjektet me peshën më të lartë të zhdoganimeve). Marzhi i shumicës mbulon kostot e imbotilimit, ambalazhimit, si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operacionale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuuar. Në rastet kur ndërmjet shitesit me shumicë dhe shitësit me pakicë operon një hallkë ndërmjetëse, marzhi i llogaritur 4% (4 lekë/kg) ndahet ndërmjet tyre.
Miell	65 lekë/kg	33%	21.5 lekë/kg			4.60%	4 lekë/kg	90.5 lekë/kg	Baza e përdorur për llogaritjen e çmimit me shumicë është kostoja mesatare e ponderuar e zhdoganimeve gjatë datave 24–31 mars 2022, ku për bazë janë marrë 99.2% e zhdoganimeve të grurit. Marzhi i shumicës mbulon kostot e përpunimit të grurit dhe prodhimit të miellit, ambalazhimit, firot ligjore, si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operacionale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuuar. Në rastet kur ndërmjet shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë operon një hallkë ndërmjetëse, marzhi i llogaritur 4% (4 lekë/kg) ndahet ndërmjet tyre.